REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 691 Prot Maliq, më 04.05.2026

VENDIM

Nr 57, datë 30.04.2026

PËR LEHTËSIMIN E PËRKOHSHËM NGA DETYRIMI PËR PAGESËN E TAKSËS SË TOKËS BUJQËSORE PËR FAMILJET BUJQËSORE, TOKA E TË CILAVE ËSHTË E PËRMBYTUR DHE E PAMUNDUR PËR T'U SHFRYTËZUAR GJATË VITIT BUJQËSOR 2026 NGA DËMTIMET E FORCAVE MADHORE TË NATYRËS

Në mbështetje të: ligjit nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar,neni 8,pika 2,neni9,pika 1,nënpika 1.1,gërma"b", neni 64 *"Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë"*, gërma "c", ligjit nr.9632/2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar; neni 21, pika5, gërma "b", Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Lehtësimin e përkohshëm në masën 75% nga detyrimi për pagesën e taksës së tokës bujqësore për familjet bujqësore,sipas listës bashkëlidhur, toka e të cilave është e përmbytur nga rreshjet e muajve nëntor 2025-janar 2026, dhe është e pamundur për t'u shfrytëzuar gjatë vitit bujqësor 2026.
2. Lehtësimi i përkohshëm në masën 75% nga detyrimi për pagesën e taksës së tokës bujqësore, do të jetë i vlefshëm vetëm për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi,ngarkohet Sektori i Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Maliq.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 04.05.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ